

Pas përhapjes së lajmit se nesër, pas namazit të xhumasë, te xhamia e madhe në Prishtinë, do të ketë protestë në shenjë pakënaqësie për arrestimin e fundit, shumë hoxhallarë bënë thirrje që të mos dilet në këtë protestë. Thirrjes për mos t'iu bashkangjitur protestës ia janë përgjigjur shumë besimtarë. Këtë ata e kanë shprehur me reagimet e tyre nëpër rrjetet sociale.

Më poshtë mund të lexoni disa nga këto reagime:

Hoxhë Fatmir Latifi

Imami i xhamisë së Shipolit në qytetin e Mitrovicës, Fatmir Latifi, duke e komentuar thirrjen për një protestë eventuale në shenjë solidarizimi me hoxhallarët e arrestuar, ka theksuar se është kategorikisht kundër çdo proteste të cilat kanë të bëjnë me arrestimet e hoxhallarëve.

Imami Latifi ka thënë për Telegrafin se ka besim të "plotë në pafajësinë e hoxhallarëve dhe vëllezërve tanë".

"Andaj çdo thirrje në këtë drejtim është dhe konsiderohet si provokim dhe thirrje në destabilitet të vendit tonë edhe ashtu të brishtë. Unë shkurt e shqip ju them besimtarëve myslimanë që përfshirja në protesta eventuale, të cilat mund të mbaheshin nesër, është e haram (e ndaluar)", ka thënë ai. /Telegrafi/

[Post](#) by [Llokman Hoxha](#).

[Post](#) by [Hoxhë Lulzim Susuri](#).

[Post](#) by [Bekir Halimi](#).

[Post](#) by [Hadith Miftari](#).

[Post](#) by [Nehat Ajeti](#).

[Post](#) by [Omer Berisha](#).

[Post](#) by [Amir Ahmeti](#).

[Post](#) by [Sabit Gashi](#).

[Post](#) by [Rashit Zylfiu](#).